



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 994/1 Prot.

Tiranë, më 07.07.2025

V E N D I M

Nr. 158, datë 07.07.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 149 Regj., datë 25.06.2025, të shtetasit L. M, kundër Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër¹” dhe “gjendjen sociale” të tij.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, shtetasi L. M, në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, ka shpjeguar problematikën e lindur mes tij dhe punëdhënësit, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), e cila, konsiston në si më poshtë:

Z. M mban detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Komunikimit të Riskut dhe Monitorimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së.

Me Urdhrin nr. 3356 prot., datë 17.06.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, është vendosur pezullimi i tij nga detyra, për një periudhë të pacaktuar, duke ndërprerë dhe marrëdhëniet financiare.

Pala ankuese, Urdhrin sipërcituar e kundërshton duke e konsideruar të pambështetur në prova e ligj.

Në parashtrimet e tij, z. M shprehet se, është njoftuar nëpërmjet e-maileve të datës 02.06.2025 dhe 04.06.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, se me datë 05.06.2025, duhet të paraqitej pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, për të zhvilluar një takim me Komisionin e Përhershëm të Shqyrtimit të Shkeljeve Disiplinore, me tematikë “...ndjekjen e rastit lidhur

¹ Pa shpjeguar apo dokumentuar këtë shkak.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

me incidentin e helmimit të fëmijëve në Kopshtin nr. 1, Gramsh...duke mos lënë jashtë vëmendjes dhe përgjegjësinë e mosvënien në dijeni të Drejtorit të Përgjithshëm nga ana e Drejtorisë së Komunikimit të Riskut dhe Monitorimit, lidhur me njoftimet në media...”

Subjekti ankues, përsa më sipër, shpjegon ndër të tjera se: “Nga ana ime si Drejtor i Drejtorisë së Komunikimit të Riskut dhe Monitorimit, por edhe nga Sektori i Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional, në mënyrë sistematike janë mbajtur komunikime me Drejtorin e Përgjithshëm duke u konsultuar dhe koordinuar për çdo rast të ardhur, komunikim i shpjegues ndaj çdo DRAKU (Drejtore Rajonale të AKU-së), menaxhimin e tij në terren e deri tek informimi i publikut apo edhe mediave nëpërmjet deklaratave publike të dala.

Sa i përket rastit konkret, theksoj se rasti nuk është adresuar në asnjë prej rrjeteve zyrtare të komunikimit të AKU-së, por rasti është denoncuar pranë portaleve (konkretisht portalit JOQ). Menjëherë sapo përfaqësues të Sektorit të Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional e kanë hasur lajmin, kanë bërë me dije m qëllim ndjekjen e menjëhershme të tij, pra nga e-maili zyrtar info@aku.gov.al është adresuar pranë DRAKU Elbasan për trajtim.

Theksoj se rasti është ndjekur jashtë orarit zyrtar, në fundjavë, dhe kjo për shkak të përgjegjshmërisë dhe detyrës primare për të garantuar mbarëvajtjen e punës dhe garantimin e sigurisë ushqimore në vend. Edhe pse Kodi i Punës citon 40 orë punë në javë, kjo gjë nuk ka qenë pengesë për mua apo Drejtorinë që drejtoj dhe s’ ka qenë kurrë kufizim për shkak të dinamikave që ka natyra e punës tonë. Në asnjë pikë të Rregullores së Brendshme nuk citohet monitorimi 24 orë i mediave, e para sepse është e pamundur dhe e dyta se nuk është as detyrë imja funksionale.”

Lidhur me problematikën në fjalë, ankuesi pretendon se cedimi për rastin sipërcituar ka ardhur nga institucionet e tjera ligjzbatuese dhe jo nga AKU, pasi në rastin kur Spitali, Policia e Shtetit apo cilido institucion tjetër kishte ardhur në dijeni të rastit, AKU-ja, si institucioni kryesor i garantimit të sigurisë ushqimore në vend, duhet të ishte njoftuar dhe vënë në lëvizje.

Ankuesi shprehet se ai ka kryer çdo detyrë dhe veprim që i ngarkon funksioni i tij, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe se nuk ka kryer asnjë shkelje të këtyre dispozitave as me veprime, as me mosveprime.

Ndër të tjera, ankuesi citon se: “...kam arsye të mendoj se masa ndaj meje është e padrejtë dhe bazuar në qëndrime diskriminuese që mund të lidhen me bindjet, përkatësinë time apo faktorë të tjerë personalë që nuk lidhen me performancën apo sjelljen profesionale.”

Z. M pretendon se, Urdhri për pezullimin e tij nga detyra është ndërmarrë vetëm ndaj tij dhe jo ndaj përgjegjësit të Sektorit dhe tre specialistëve të tjerë të këtij Sektori, pavarësisht faktit se ai si Drejtor nuk ka kryer asnjë shkelje të detyrave funksionale të tij, duke cituar se: “Vendimi për pezullim, i marrë ndaj meje nga AKU, nuk gjen asnjë mbështetje ligjore në kuadër të legjislacionit shqiptar në fuqi. Asnjë dispozitë e Kushtetutës, ligjeve të posaçme apo akteve nënligjore nuk parashikon pezullimin si masë ndëshkuese administrative apo parandaluese, në rastin konkret.

Në mungesë të një baze ligjore të qartë dhe të saktë, çdo veprim që cenon të drejtat dhe statusin juridik të një individi përbën tejkalim të kompetencës dhe shkelje të parimit të shtetit të së drejtës.

...

Ndërprerja e marrëdhënieve financiare përbën një cenim të drejtpërdrejtë të jetesës sime dhe stabilitetit ekonomik. Kjo masë, e marrë në mënyrë të njëanshme dhe pa asnjë bazë ligjore, ka sjellë pasoja të menjëhershme dhe të rënda në jetën time të përditshme, duke më privuar nga të ardhurat që mbulojnë nevojat bazë jetike, si ushqimi, banesa, detyrimet financiare dhe përkujdesja ndaj familjes.

Për më tepër, një ndërprerje e tillë, në mungesë të një vendimi të formës së prerë nga një organ kompetent, përbën jo vetëm një akt të padrejtë, por edhe të pashmangshëm në efekte e tij negative, duke më vendosur në një situatë të paqëndrueshme dhe të padrejtë nga pikëpamja sociale, ekonomike dhe psikologjike.

Ky vendim më ka krijuar një vuajtje shpirtërore, stres emocional dhe pasoja psikologjike të pësura për shkak të paligjshmërisë së tij dhe faktit që është i padrejtë, duke prekur rëndë dinjitetin tim dhe jetën time të përditshme.

Rrethanat e çështjes dhe pasojat e rënda psikologjike, sociale dhe emocionale më janë shkaktuar si pasojë e vendimit të paligjshëm për pezullim dhe ndërprerje të të ardhurave.”

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri: “*Shfuqizimin e aktit administrativ “Urdhër nr. 3356 prot., datë 17.06.2025 “Për pezullimin e përkohshëm në detyrë” të AKU dhe rikthimin në detyrë”.*

- Pas depozitimit të ankesës nëpërmjet e-mailit datë 24.06.2025, në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave (DPA), pranë KMD-së, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, lidhur me provueshmërinë e disa prej deklarimeve të bëra prej tij me shkaqet e pretenduara, sipas shënimeve në formularin e ankesës kundrejt punëdhënësit, AKU-së.
- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mailit datë 24.06.2025, nga ana e specialistes së DPA/KMD është proceduar me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit e informacionit të nevojshëm për vijimin e shqyrtimit të ankesës së tij.
- Në vijim të sa më sipër, nëpërmjet e-mailit me datë 24.06.2025, si dhe nëpërmjet shërbimit postar (administruar pranë KMD-së me shkresën me nr. 994 prot., datë 25.06.2025) ankuesi ka dërguar sërish shpjegimet e tij, të cilat janë shtjelluar tek pjesa I -rë, e vendimit, por, nuk ka depozituar asnjë shpjegim, fakt e provë përsa i është kërkuar lidhur me shkaqet e cituara dhe provueshmërinë e lidhjes mes shkakut/shkaqeve dhe trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm të pretenduar prej tij.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga këqyrja e analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, si dhe referuar deklarimeve të subjektit ankues, rezulton se:

Subjekti ankues, L. M mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Komunikimit të Riskut dhe Monitorimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së.

Nëpërmjet Urdhrit nr. 3356, datë 17.06.2025 “Për pezullimin e përkohshëm në detyrë”, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, është urdhëruar si më poshtë citohet:

“1. Pezullimi nga detyra i z. L. M, Drejtorit i Drejtorisë së Komunikimit të Riskut dhe Monitorimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, duke filluar nga data 18.06.2025 deri në një urdhër të dytë.

2. Pezullimi nga detyra bëhet me qëllim ruajtjen e interesit të punëdhënësit si dhe mundësimin e një hetimi të paanshëm e të pavarur në rastet e shkeljeve të rënda ose të pretenduara, me qëllim:

- ruajtjen e integritetit dhe objektivitetit të procesit disiplinor;*
 - parandalimin e çdo ndikimi të mundshëm mbi punonjësit e tjerë apo mbi faktet që po verifikohen nga Komisioni i Përhershëm i Shqyrtimit të Shkeljeve Disiplinore pranë DP AKU-së;*
 - sigurimin e funksionimit të pandikuar të strukturave (sektorëve) të varësisë së tij;*
 - mbrojtjen e interesit institucional të AKU-së, si dhe reputacionit institucional si autoritet publik me përgjegjësi të lartë;*
 - parandalimin e rrezikut që përbën qëndrimi i punëmarrësit në funksion gjatë hetimit administrativ për zbardhjen e së vërtetës ose për cenimin e objektivitetit të procesit.*
- 3. Gjatë periudhës së pezullimit, punonjësi nuk përfiton pagë...”*

Ankuesi, para KMD-së pretendon për veprime të padrejta, të pambështetura në fakte, prova dhe legjislacion, nga ana e AKU-së karshi tij. Ai shprehet se kjo situatë (*pezullimi i tij nga detyra, pa një afat të caktuar dhe pa të drejtë page*) i ka krijuar atij, shqetësime, problematika dhe stres, duke cenuar rëndë dinjitetin dhe sigurinë financiare për familjen e tij. Ai shprehet se, *“ky urdhër përveçse i padrejtë e ka vendour atë në një situatë të paqëndrueshme dhe të padrejtë nga ana sociale, ekonomike dhe psikologjike”*.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se është diskriminuar nga ana e AKU-së, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim “për çdo shkak tjetër”.

Subjekti ankues ka shënuar “çdo shkak tjetër” tek lista e shkaqeve në formularin e ankesës të KMD-së, pa shpjeguar e argumentuar atë.

Ankuesi ka pretenduar për trajtim të padrejtë të tij, nga ana e AKU-së, pa dhënë ndonjë shpjegim apo fakte e prova se ky trajtim bazohet në ndonjë karakteristikë, apo cilësi të veçantë të tij, bazuar mbi të cilën të prezumohej trajtimi i tij i pafavorshëm e i padrejtë.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet*

politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe të mbrojtura, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të paraqet fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë, të padrejtë e të pafavorshëm të tij nga ana e AKU-së, vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë i provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur nga LMD.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh³. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁴.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”*⁵

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bëjnë të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak

³ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁴ Neni 14, i KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

⁵ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim.

Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë. Komisioneri vlerëson se, diskriminimi⁶ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Pala ankuese nuk provon me fakte e prova se mbart shkaqet e pretenduara, sipas përcaktimeve të LMD-së. Në kuptim të LMD-së, *“Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.”*⁷.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes. Kjo pasi, ankuesi nuk ka arritur të provojë apo dokumentojë se çfarë konsideron me “çdo shkak tjetër”, pra se cila është karakteristika e tij individuale, bazuar mbi të cilën subjektet kundër të cilëve ka paraqitur ankesën, e kanë trajtuar në mënyrë të diferencuar e të padrejtë.

⁶ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

⁷ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Në mungesë të provave e fakteve mbi të cilat supozohet se ka pasur diskriminim, pamundësohet vijimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi.

Pala ankuese nuk parashtroi e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucionit përgjegjës që të jenë motivuar nga shkak i pretenduar, pasi *vetë shkak* nuk është i provuar prej tij.

Vetëm pasi ankuesi të provonte para KMD-së se mbart e posedon shkakun e pretenduar, atëherë Komisioneri mund të vihej në lëvizje për të kërkuar informacion lidhur me veprimet apo mosveprimet e institucionit përkatës.

Komisioneri vëren se, arsyetimi dhe motivacioni i përdorur nga punëdhënësi për pezullimin e ankuesit në detyrë dhe ndërprerjen e pagës gjatë tij, mund të lidhen me ligjshmërinë apo jo të veprimeve, të AKU-së, por nuk lidhen me cilësitë e karakteristikat e identifikueshme të ankuesit në kontekst të shkakut të mbrojtur sipas LMD-së.

Me të njëjtën logjikë, Komisioneri argumenton se, ankuesi kur citon shkaqet e “*gjendjes sociale, ekonomike*”, për të cilat pretendon diskriminimin nga ana e AKU-së, evidenton faktin se këto shkaqe ai i lidh me *pasojat* që i vijnë nga pezullimi i marrëdhënieve të punës dhe ndërprerëja e pagës gjatë gjithë periudhës së pezullimit, në kontekst të vështirësisë dhe paqëndrueshmërisë që i është krijuar atij nga *pikëpamja sociale, ekonomike dhe psikologjike, gjë që cenuar jetesën dhe sigurinë financiare të familjes së tij*, dhe jo me faktin që veprimet e punëdhënësit/AKU-së kanë ardhur pikërisht për shkak se ai posedon këto cilësi apo shkaqe apo të jenë motivuar prej tyre.

Ankuesi nuk ka parashtruar apo sqaruar rrethana me fakte e prova se si ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e AKU-së, apo se si ky trajtim lidhet me shkaqet e pretenduara prej tij.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqet sipërcituar, Komisioneri vëren se, *parimisht*, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi janë mosha e gjinia e ankueses

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”⁸, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues L. M, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁸ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 205, datë 19.10.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 226, datë 06.11.2023, të KMD-së, Vendimi nr. 27, datë 23.01.2024, Vendimin nr. 45, datë 03.03.2025, Vendimin nr. 66, datë 02.04.2025, etj.